



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore**

*Adresa Rruga "Abdi Toptani", nr.1, Tiranë "*

*E-mail: klsh.org.al; web-site: www.klsh.org.al*

Nr. 587/5 Prot.

Tiranë, më23/12/2020

**V E N D I M**

**Nr. 132, Datë 2/12/ 2020**

**PËR AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË DHE FINANCIAR TË USHTRUAR NË  
APARATIN E KRYEMINISTRISË, TIRANË  
për periudhën nga data 01.01.2016 deri në 30.06.2020**

Nga auditimi i ushtruar në Aparatin e Kryeministrisë, Tiranë, rezultoi që përgjithësisht është vepruar në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, me dispozitat e tjera që normojnë veprimtarinë e institucionit, si dhe me përcaktimet e ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003. "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave". Krahas sa më sipër, u konstatuan edhe disa mangësi në fushën e kontabilitetit dhe kontrollit të brendshëm, të cilat konsiderohen devijime jo materiale dhe jo të përhapura, mbi të cilat mbështetet dhëniea e opinionit të pa kualifikuar mbi pasqyrat financiare dhe përputhshmërisë.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*",

**V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit të ushtruar në Aparatin e Kryeministrisë me objekt "*Auditim Financiar dhe Përputhshmërie*", sipas Programit të Auditimit, miratuar me nr.587/1, datë 30.06.2020, për veprimtarinë nga data 01.01.2016 deri në 30.06.2020.

II. Të miratoj Opinionin e Auditimit, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

### **A. OPINIONI I AUDITIMIT:**

#### ***Baza për opinionin e pakualifikuar me theksim të çështjes mbi pasqyrat financiare:***

Ne kemi audituar veprimtarinë e aparatit të Kryeministrisë në mbështetje të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe ISSAI 1700<sup>1</sup>, dhe ISSAI 4000<sup>2</sup>.

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e manualit të auditimit financiar të KLSH si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAIs), në parimet INTOSAI-P1, “Deklarata e Limës”; INTOSAI-P 10, “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe INTOSAI-P 12, INTOSAI-P 20, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin financiar, të cilat janë përmendur në ISSAI 2000-2899 “Standardet e Auditimit Financiar”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së.

Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet buxhetore, KLSH është e pavarur nga Kryeministria dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e **opinionit të pakualifikuar me theksim të çështjes**<sup>3</sup>.

#### ***Ne vumë re se:***

-Nga komisionet e inventarizimit nuk janë mbajtur procesverbale në lidhje me inventarizimin e magazinës, sa parashikuar nga paragrafi 82, i UMF nr.30/2011, i ndryshuar.

- Megjithëse është kryer inventari i vitit 2019, nuk është hartuar raporti për inventarizimin e aktiveve gjendje në magazinë, inventarizimi i materialeve në përdorim dhe materialeve që janë jashtë përdorimit, e që janë gjendje në zyrat e punonjësve dhe në ambientet e Kryeministrisë, në kundërshtim me pikën “c”, të Urdhrit të Sekretarit të Përgjithshëm nr. 35, datë 3.1.2018 si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, paragrafi 85/c. Në këto kushte, grupi i auditimit nuk jep dot siguri të arsyeshme për vlerën kontabël të inventarëve, të reflektuar në pasqyrat financiare, deri në finalizimin e procesit të inventarizimit.

#### **I.Opinion për auditimin financiar:**

Nga auditimi i pasqyrave financiare, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualet e Auditimit Financiar, përsa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti Kryeministria, të standardeve të kontabilitetit, të ligjit mbi

<sup>1</sup>ISSAI 2700- Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

<sup>2</sup>ISSAI 4000 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

<sup>3</sup>- Sipas **Manualit të Auditimit Financiar** të KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 64, datë 22.06.2020, kapitulli 4.2.2 , fq 139: “ Një opinion i pamodifikuar jepet kur audituesi arrin në konkluzionin se për të gjitha aspektet materiale, pasqyrat financiare paraqesin një pamjen të vërtetë dhe të drejtë si dhe pasqyrat janë përgatitur në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar

kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, udhëzimeve e kushteve të vendosura apo termave mbi raportimin financiar, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit financiar*), u evidentua se informacioni financiar i këtij subjekti, është paraqitur në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar dhe se pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Në opinionin tonë, veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit, me përjashtim të çështjeve të trajtuara në bazën për theksimin e çështjes së opinionit, janë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike, përfshirë rregullat për prokurimet dhe ato të buxhetit.

### ***Baza për opinionin e pakualifikuar të përputhshmërisë:***

Ne kemi audituar veprimtarinë e aparatit të Kryeministrisë në mbështetje të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*” dhe ISSAI 1700<sup>4</sup>, dhe ISSAI 4000<sup>5</sup>.

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e manualit të auditimit të përputhshmërisë dhe atij financiar të KLSH si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAIs), në parimet INTOSAI-P1, “*Deklarata e Limës*”; INTOSAI-P 10, “*Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t*”, si dhe INTOSAI-P 12, INTOSAI-P 20, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “*Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë*” si dhe ISSAI 2000-2899 “*Standardet e Auditimit Financiar*”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së.

Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet buxhetore, KLSH është e pavarur nga Kryeministria dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e **opinionit**.

### ***II. Opinion për auditimin e përputhshmërisë<sup>6</sup>:***

Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 400, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, nën gjykimin tonë, aktiviteti i Kryeministrisë, në përgjithësi është kryer në përputhje me kuadrin rregullator. Megjithatë, nga auditimi i përputhshmërisë, u konstatuan edhe disa të meta e parregullsi, të konsideruara ***jo materiale dhe jo të përhapura***, për të cilën japim ***opinion të pakualifikuar***<sup>7</sup>.

*Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:*

<sup>4</sup>ISSAI 2700- Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

<sup>5</sup>ISSAI 4000 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

<sup>6</sup> -Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së*”.

<sup>7</sup> -Sipas **Manualit të Auditimit Përputhshmërisë** të KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 66, datë 23.06.2020, Kapitulli 4.7, pika 7.2: “*Kur nuk janë gjetur apo konstatuar raste të mospërputhjeve materiale në një angazhim të sigurisë së arsyeshme, audituesi shpreh opinion të pamodifikuar ose të pakualifikuar që informacioni i përgatitur, është në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e aplikueshme.*”

Drejtimi i aparatit të Kryeministrit është përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar për të mundësuar përgatitjen e tyre pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm efektiv.

*Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:*

Përgjegjësia e auditimit është të shprehë një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar në rezultatet e auditimit të kryer, për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Audituesit e KLSH-së nëpërmjet auditimit të realizuar në këtë institucion krijuan bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare, raportimit financiar (*kriteret e auditimit financiar*) dhe shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), ku veprimet janë kryer në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi (*kriteret*), dhe që gabimet apo parregullsitë e vërejtura, nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë jo materiale dhe jot ë përhapura.

Objekti ynë lidhet me dhënien e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Aparatit të Kryeministrit, me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara, administrative si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve administrative të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH, kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

## **B. PROPOZIME PËR PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI:**

### **1. Gjetje nga auditimi:**

Për të gjithë periudhën objekt auditimi, janë kryer shpenzime për udhëtime jashtë vendit në 1,173 raste me vlerë totale 127,810,098 lekë. Procedurat e ndjekura për kryerjen e këtyre shpenzimeve dhe veçanërisht për blerjen e biletave të udhëtimit jashtë shtetit të Kryeministrit dhe stafit të tij shoqëruar, janë bërë për arsye të domosdoshme dhe në disa raste emergjente dhe nuk janë kryer sipas rregullave të prokurimit publik, por janë bazuar në VKM Nr.420, datë 08.06.2016 “Për miratimin e ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë”, i cili përcakton se, “Kryeministri, si rangu më i lartë i pushtetit ekzekutiv në Shqipëri, ka të drejtën e një ceremoniali të veçantë në të gjitha aspektet zyrtare dhe jozyrtare të jetës dhe aktivitetit të Tij”. Nga auditimi u konstatua se, aktet nënligjore të ceremonialit zyrtar shtetëror siç është edhe VKM e sipërcituar, nuk janë të harmonizuara me aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë fushën e prokurimit publik. Pikërisht, nisur nga kjo specifikë e veçantë që ka ceremoniali i Kryeministrit, del mëse e domosdoshme marrja e iniciativave ligjore nga vetë institucioni i Kryeministrit, për të hartuar aktet nënligjore, me qëllim thjeshtësimin dhe lehtësimin e procedurave të blerjeve të biletave të udhëtimit dhe akomodimit të Kryeministrit dhe stafit ndihmës e shoqëruar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 49-57 të Raportit të Auditimit*)

### **1. Rekomandimi:**

Nga strukturat përgjegjëse të Kryeministrisë, të ndërmerret iniciativa ligjore për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore, me qëllim harmonizimin e akteve ligjore e nënligjore të ceremonialit zyrtar shtetëror, me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë fushën e prokurimit publik.

*Menjëherë dhe në vijimësi.*

## **C. MASA ORGANIZATIVE:**

### **1.Gjetje nga auditimi:**

Nuk janë hartuar dhe dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë sipas kërkesave të nenit 43, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, raportet e monitorimit periodike progresive të zbatimit të buxhetit, për vitet 2018 dhe 2019 si dhe këto raporte nuk janë publikuar në faqen zyrtare të institucionit. Kjo situatë është korrigjuar për vitin 2020.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 14-23 të Raportit të Auditimit)*

#### **1.1.Rekomandimi:**

Institucioni referuar Udhëzimit të sipërshënuar të marrë masa për publikimin në faqen zyrtare (web) të institucionit të raporteve 4-mujore të monitorimit që i dërgohet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

*Në vijimësi.*

### **2.Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i aktiveve (aseteve) të regjistruar në kontabilitet u vërejt se, vlera e mbetur e disa prej tyre, pasi i është zbritur amortizimi i akumuluar ndër vite, rezulton të jetë zero ose me vlera të papërfillshme, pavarësisht se aktivi është në përdorim dhe në gjendje pune. Nga ana e strukturave të Kryeministrisë nuk është bërë vlerësim i jetës së dobishme të aktiveve, referuar Paragrafit nr.103, të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. Rivlerësimi i jetës së dobishme të aktiveve nuk është kryer, pasi komisioni i vlerësimit të aktiveve nuk ka funksionuar, sepse disa nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të aktiveve, ( ngritur me ekspertë të fushave, sipas Urdhrit të Sekretarit të Përgjithshëm me nr. 353, datë 18.01.2019), janë larguar dhe nuk janë aktualisht në marrëdhënie pune me këtë institucion.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 26-49 të Raportit të Auditimit)*

#### **2.1.Rekomandimi:**

Të riformatohet komisioni i vlerësimit të aktiveve, duke e plotësuar me ekspertë të fushave, në përmirësim të Urdhrit të Sekretarit të Përgjithshëm me nr. 353, datë 18.01.2019, meqenëse disa nga anëtarët e komisionit të mësipërm, nuk janë aktualisht në marrëdhënie pune me institucionin, me qëllim për të saktësuar vlerën e mbetur të këtyre aktiveve, destinacionin e mëtejshëm ose propozimin për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës.

*Menjëherë*

### **3.Gjetje nga auditimi:**

Për sistemin e ngrohjes dhe ftohjes së institucionit, referuar situacioneve të shpenzimeve të kontabilizuara, në emërtimin “Sistemi i Kondicionimit”, konstatohet se, vlera e këtij sistemi është i mbajtur dhe regjistruar në kontabilitet në dy llogaritë ndryshme, në vend që të bashkohej dhe të regjistrohej në një llogaritë vetme të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, pikërisht në nënlllogarinë “Sisteme kondicionimi”. Konkretisht është regjistruar, si më poshtë:

-Gjatë vitit 2019 janë blerë dy sisteme kondicionimi të reja me vlerë 54.4 milionë lekë e cila është regjistruar në kontabilitet në llogarinë 214 “*Instalime teknike, makineri dhe pajisje*” dhe;

-Pjesa e sistemit të vjetër të kondicionimit në vlerën 58 milionë lekë është e përfshirë në vlerën totale të godinës që është e kontabilizuar në llogarinë 212 “*Ndërtesa dhe rikonstruksione*”.

Sa më sipër, nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10296/2010, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” mbi rregullat, kriteret e evidentimit dhe kontabilizimit të Aktiveve Afatgjata Materiale.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 26-49 të Raportit të Auditimit)*

### **3. Rekomandimi:**

**3.1.**Nëpunësi zbatues, të marrë masat për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Aktiveve Afatgjata Materiale me qëllim saktësimin e vlerës së aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara në nënlllogarinë “Sisteme kondicionimi”.

*Në vijimësi*

**3.2.** Nëpunësi zbatues, i cili sipas ligjit 10296, datë 08.07.2010 me ndryshime “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12, pika 2/ë është përgjegjës për: “*Mbajtjen e sistemit të kontabilitetit, raportimit për vendimmarrjen, në funksion të realizimit të objektivave, kontabilizimin e plotë, të saktë dhe në kohë të të gjitha transaksioneve, si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të njësisë, në përputhje me rregullat e miratuara nga Ministria e Financave*”, bazuar në rezultatet e Komisionit të Vlerësimit, vlerën e përlllogaritur të amortizimit për këtë kategori të Aktiveve Afatgjata Materiale, vlerën e aktiveve afatgjata të transferuara të aktiveve (të përfshira në sistemin e kondicionimit) të kryejë veprimet përkatëse sistemuese në kontabilitet, dhe t’i pasqyrojë në bilancin kontabël që do të mbyllet për ushtrimin e vitit 2020.

*Në vijimësi*

### **4.Gjetje nga auditimi:**

Referuar raportit të auditimit të KLSH të mbajtur për auditimin e llogarive të vitit 2015, (shkresa e KLSH nr. 436/6, datë 07.10.2016), rezulton se pavarësisht masave të marra deri në mbajtjen e këtij raporti, nuk është vendosur në kushtet e arkëtimit vlera e regjistruar si detyrim debitor për subjektet dhe ish-zyrtarët e institucionit dhe se teprica e kësaj llogarie kontabile paraqitet për 10,091,723 lekë. Të gjithë këto debitorë ndonëse kanë një kohë të gjatë që janë krijuar, nuk kanë rezultuar të arkëtohen, si zanafillë e detyrimeve të krijuara janë nga viti 1999 dhe 2001 dhe që janë pa shpresa arkëtimi.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 26-49 të Raportit të Auditimit)*

### **4. Rekomandimi:**

**4.1.**Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues të marrim masat për ndjekjen e detyrimeve debitore dhe kreditore dhe të vendosin në kushtet e arkëtimit vlerat e debive të regjistruara në kontabilitet. Të merren masat që të evidentohen në mënyrë kontabël, të gjitha detyrimet financiare të angazhimit

dhe ato të konstatuara në zbatim të kërkesave ligjore, me qëllim njohjen e detyrimeve financiare në kohën e krijimit, programimin e likuidimit të detyrimeve ndaj të tretëve dhe zvogëlimin e borxhit financiar.

*Në vijimësi*

**4.2.**Nëpunësi zbatues, i cili sipas ligjit 10296, datë 08.07.2010 me ndryshime “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12, pika 2, germa “g”, është përgjegjës për: “*garantimin e mbledhjes së të gjitha borxheve të paarkëtuara dhe, në rastet kur nuk është i mundur të mbledhet ky borxh, duhet të ketë dokumentacion të plotë për të vërtetuar që kryen të gjitha përpjekjet për mbledhjen e tij, me përjashtim të rasteve kur përgjegjësia rregullohet me ligje të veçanta*”, të marrë masat që të dërgohen shkresa zyrtare për arkëtimin e detyrimeve, për debitorët që janë me shpresë arkëtimi, ndërsa për debitorët që janë pa ndonjë shpresë arkëtimi, ti propozohet Ministrisë së Financave që ti mbajnë në llogaritë jashtë bilancit, ose të ndiqet procedurat ligjore për parashkrimin e tyre.

*Në vijimësi*

### **5.Gjetje nga auditimi:**

Pavarësisht përpjekjeve dhe takimeve të zhvilluara, nuk është adresuar ekzekutimi vendimit gjyqësor të formës së prerë për një ish-punonjës të larguar nga puna i cili qëndron kreditor. Nuk janë kryer përlllogaritjet e vlerës së detyrimit financiar nga ana e Sektorit të Financës dhe Buxhetit në Kryeministri, për pasojë vlera e këtij detyrimi nuk është evidentuar dhe regjistruar në kontabilitet (në pasqyrat financiare), ndonëse vendimi gjyqësor është i vitit 2016.

Sa sipër, nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i paragrafit nr.42, kapitulli 3.1, “Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, të UMFE nr. 8, date 9.3.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 26-49 të Raportit të Auditimit)*

### **5. Rekomandimi:**

Njësia e Buxhetit dhe Administrimit dhe Sektori i Financës dhe Buxhetit, në çdo rast, me marrjen dijeni për vendimet gjyqësore të formës së prerë në favor të ish-punonjësve të larguar padrejtësisht nga puna, të marrin masat për likuidimin në kohë të këtyre detyrimeve që lindin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë dhe mos lejojnë krijimin e kostove shtesë apo shpenzimeve të panevojshme për pagesat e përmbaruesve gjyqësorë. Kjo në përputhje me procedurat e parashikuara në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.2, datë 18.08.2011 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Në këtë kuadër, të merren masat për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë për kreditorin Znj. L.S, duke kryer përlllogaritjet e detyrimit financiar nga ana e Sektorit të Financës dhe Buxhetit në Kryeministri; vlera e këtyre detyrimeve të regjistrohet në kontabilitet dhe të evidentohet në pasqyrat financiare të institucionit.

*Në vijimësi*

### **6.Gjetje nga auditimi:**

**6.1.**Për periudhën objekt auditimi nuk rezultojnë të jenë kryer regjistrimi i pronësisë dhe kufijtë e pasurive të paluajtshme në inventarin e shtetit sipas kërkesave të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar). Po kështu nuk është regjistruar pasuria në Zyrën e Kadastrës

Shtetërore, në bazë të përcaktimeve të ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, i ndryshuar si dhe ligjit nr. 33/2010 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

**6.2.** Sipërfaqet e trojeve në llogarinë nr.210 si dhe vlerat e tyre në vitin 2016, 2017, 2018 dhe 2019, nuk janë regjistruar në bilancin kontabël dhe janë evidentuar për vlefën 0 lekë. Sipërfaqja totale e tokës që ka Kryeministria në dispozicion nuk është vlerësuar dhe nuk është pasqyruar në kontabilitet. Për sa sipër, nuk ka gjetur zbatim pika 3.3 “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar (bilanci)” , paragrafi 62, dhe paragrafi 91, të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.  
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 26-49 të Raportit të Auditimit)*

## **6. Rekomandimi:**

**6.1.**Të ngrihet një grup pune për të pasqyruar dinamikën dhe lëvizjet e aktiveve afatgjata materiale, të ndërtojë gjurmën e auditimit të këtyre pasurive, duke saktësuar dhe administruar dokumentacionin e nevojshëm, dhe mbi këtë bazë të ndërmerren veprimet e nevojshme ligjore dhe të aplikohet për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të institucionit.

*Menjëherë e në vijimësi*

**6.2.**Të ngrihet një grup pune me qëllim identifikimin me planimetri dhe genplane të sipërfaqes së tokës truall që i përket institucionit dhe pas përlllogaritjes së vlerave nga ekspertët e fushës, të ndërmerren veprimet e nevojshme të regjistrimit të saj në kontabilitet, duke evidentuar situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit dhe në pajtueshmëri me legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

## **7. Gjetje nga auditimi:**

Për periudhën 2016 - 2020 janë kryer dy procedura të inventarizimit të pasurisë: në vitin 2018, bazuar në pasqyrat e llogaridhënies vjetore të datës 31.12.2017 dhe në vitin 2019, bazuar në bilancin financiar të datës 31.12.2018.

Sa sipër, është vepruar në kundërshtim me paragrafin nr. 74, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar me Udhëzimin nr.24, datë 07.12.2016, nr.11, datë 06.05.2016 dhe nr.20 datë 17.11.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Gjithashtu konstatohet se:

-Nga komisionet e inventarizimit nuk janë mbajtur procesverbale në lidhje me inventarizimin e magazinës, sa parashikuar nga paragrafi 82, i UMF nr.30/2011, i ndryshuar.

- Megjithëse është kryer inventari i vitit 2019, por nuk është hartuar raporti për inventarizimin e aktiveve gjendje në magazinë, inventarizimi i materialeve në përdorim dhe materialeve që janë jashtë përdorimit që janë gjendje në zyrat e punonjësve dhe në ambientet e Kryeministrisë, në kundërshtim me pikën “c”, të Urdhrit të Sekretarit të Përgjithshëm nr. 35, datë 3.1.2018 si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, paragrafi 85/c.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 26-49 të Raportit të Auditimit)*



## **7. Rekomandimi:**

**7.1.** Nga strukturat përgjegjëse, që menaxhojnë këto aktivitete të administrimit material, të kryhet një proces i kujdesshëm inventarizimi, shoqëruar gjithashtu me vlerësimin rast pas rasti të aktiveve për t'u nxjerrë jashtë përdorimit si dhe për sistemimin e diferencave. Nëpunësi Autorizues me mbylljen e rezultateve të inventarizimeve të aktiveve, detyrimisht duhet të lejë gjurmë për mbikëqyrjen e procesit dhe miratimin e procedurave deri në veprimet përkatëse të sistemit të diferencave apo kryerjes së veprimeve përkatëse për materialet që janë jashtë përdorimit.

**7.2.** Nga ana e strukturave përgjegjëse të Kryeministrit të merren masa që kryerja e inventarëve të aktiveve, nxjerrja jashtë përdorimit dhe asgjësimi i tyre, të kryhen në mënyrë të vazhdueshme e mbi baza vjetore, duke u shoqëruar me procesverbalet e vlerësimit/ nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit të aktiveve, bashkëlidhur me dokumentacionin mbi procedurën e kryer për vlerësimin dhe ndarjen e materialeve sipas destinacionit të tyre, për ankand, groposje, evidentimin e vend ndodhjes dhe groposjes së tyre, djegien, etj., shoqëruar me fotot përkatëse, mjetin e transportit i cili ka kryer transportin e tyre, duke e dokumentuar në mënyrë rigoroz procesin e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit të materialeve, në përputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*".

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

**7.3.** Komisionet e Vlerësimit të Aktiveve dhe nxjerrjes jashtë përdorimit, në përfundim të procesit të inventarizimit të aktiveve të përpilojnë një raport përmbledhës mbi procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

## **8. Gjetje nga auditimi:**

Rregullorja e brendshme e funksionimit administrativ nuk është përmirësuar pas ndryshimeve në organigramën dhe strukturën e brendshme të institucionit. Rregullorja e brendshme e funksionimit administrativ duhet të reflektojë gjithë aspektet e organizimit dhe funksionimit administrativ në institucion. Rregullorja e institucionit, e cila ka për qëllim përcaktimin e rregullave lidhur me funksionimin e brendshëm, rregullin dhe sigurinë për punonjësit e Kryeministrit dhe të institucioneve të tjera rezidente në godinën e Kryeministrit, synon të rregullojë të gjitha procedurat e brendshme të punës në institucionin e Kryeministrit, misionin, përgjegjësitë, funksionet dhe rolet e çdo departamenti/njësie/ drejtorie/sektori bazuar në praktikën më të mira ndërkombëtare, për të siguruar përmirësimin e vazhdueshëm dhe përmbushjen e objektivave për institucionin e Kryeministrit.

Për përmirësimin e kësaj rregulloreje, nga Nëpunësi Autorizues është nxjerrë Urdhri i Brendshëm nr. 7, datë 5.6.2020 "*Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e projekt rregullore se brendshme funksionale të Kryeministrit*" dhe konstatohet se grupi i punës po punon në bashkëpunim me SIGMA-n për përgatitjen e draftit final të projekt rregullore së brendshme funksionale të Kryeministrit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 26-49 të Raportit të Auditimit)*

### **8.1. Rekomandimi:**

Të merren gjithë masat për përditësimin e rregullore së organizimit dhe funksionimit të brendshëm në institucionin e Kryeministrit, duke mbajtur në vëmendje faktin se janë kompozuar

struktura e drejtori të reja, të cilat duhet të gjejnë reflektim në këtë dokument që duhet miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i institucionit.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

### **9. Gjetje nga auditimi:**

Në funksion të zbatimit të kuadrit rregullator në fuqi, nëpunësi zbatues është niveli menaxherial në vartësi direkte të titullarit i institucionit. Në funksionet e tij, Shefi i Financës dhe Buxhetit mbulon çështjet e planifikimit, zbatimit të buxhetit, kontabilitetit, monitorimit, si dhe përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore të njësisë, në përputhje me kërkesat e ligjit në fuqi. Sektori i Financës dhe Buxhetit nuk përgjigjet në strukturë përpara Sekretarit të Përgjithshëm, por përpara Drejtorisë së Administrimit të Brendshëm, e cila është pjesë e Njësisë së Buxhetit dhe Administrimit në Departamentin e Administrimit, Transparencës dhe Antikorrupsionit.

Sa sipër, nuk kanë gjetur zbatim: pika 44 e nenit 3, pika 22 e nenit 4, pika 1 e nenit 12 dhe neni 40 e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 58-70 të Raportit të Auditimit)*

#### **9.1. Rekomandimi:**

Të rregullohet pozicioni në strukturë i Nëpunësit Zbatues të institucionit, si nëpunës i nivelit të lartë menaxhues të njësisë, i cili është përgjegjës për zbatimin e rregullave që lidhen me menaxhimin financiar, kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të institucionit, si dhe përgjigjet para nëpunësit autorizues të Kryeministrit. Kjo, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin si dhe rekomandimet e dërguara nga ana e Ministrisë së Financave me shkresën nr. 13154/1 prot, datë 06.10.2016, gjatë kryerjes së procedurave të plotësimit të pozicionit të Drejtorit të Departamentit të Administrimit, Transparencës dhe Antikorrupsionit, pozicion i cili është vakant.

*Në vijimësi*

### **10. Gjetje nga auditimi:**

Për periudhën objekt auditimi, në aparatën e Kryeministrit nuk është ngritur dhe nuk ka funksionuar Njësia e Auditimit të Brendshëm, për pasojë:

-Nuk kanë gjetur zbatim të plotë përcaktimet e nenit 3 “Fusha e zbatimit të ligjit”, i ligjit Nr.114/2015, datë 22.10.2015 ”Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar.

- Nuk kanë gjetur zbatim të plotë nenit 3, i ligjit Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” , i ndryshuar.

-Nuk kanë gjetur zbatim të plotë pika nr. 1, të VKM Nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

Sa sipër, kërkesën për ngritjen dhe funksionimin e njësisë së auditimit të brendshëm, si pjesë e komponentit të “Monitorimit” në Kryeministri, e ka nënvizuar dhe Ministri i Financave me shkresën nr. 13408, datë 15.07.2019 “Mbi monitorimin e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm për Kryeministrinë për vitin 2018”, *(rekomandimi nr. 12)*.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 58 -70 të raportit të auditimit)*

#### **10.1. Rekomandimi:**

-Të merren masat për të ngritur/ themeluar funksionin e auditimit të brendshëm (Njësinë e Auditimit të Brendshëm të Kryeministrit), në përputhje me përcaktimet e ligjit Nr.114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", si dhe VKM Nr. 83, datë 3.2.2016 "Për miratimin e kriterëve të krijimit të njërive të auditimit të brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, duke mundësuar vlerësimin dhe mbikëqyrjen publike të pavarur nëpërmjet auditimit të rregullt e të përvitshëm të sistemeve të kontrollit në këtë njësi shpenzuese si dhe në 24 institucionet e varësisë së drejtpërdrejtë të saj.

- Sekretari i Përgjithshëm i Kryeministrit të marrë masat që, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, të propozojnë rishikimin e organigramës dhe strukturës organike, të miratuar sipas Urdhrit të Kryeministrit me nr. 157, datë 18.11.2019, duke krijuar Njësinë e Auditimit të Brendshëm, në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor dhe nënligjor mbi auditimin e brendshëm në sektorin publik si dhe kërkesat e ligjit Nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor".

*Në vijimësi*

### **11. Gjetje nga auditimi:**

Në institucionin e Kryeministrit është hartuar dhe miratuar regjistri i riskut për periudhën auditimit, ku janë evidentuar risqet para kontrollit, zotëruesit e këtyre risqeve, si dhe rezultatet pas implementimit të kontroleve të brendshme. Ky dokument është hartuar sipas periudhave dhe është përditësuar, duke evidentuar risqet që shtohen dhe ato që hiqen nga kjo matrice. Pjesë përbërëse e regjistrit të risqeve janë Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë (*Njësia e Akteve Rregullatore të Këshillit të Ministrave, Njësia Ligjore e Koordinimit të Nismave Prioritare dhe ACQUIS, Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA*); Departamenti i administrimit, Transparencës dhe Antikorrupsionit (*Njësia e Buxhetit dhe Administrimit, Njësia e Transparencës dhe Antikorrupsionit*); Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes (*Njësia e Programeve të Zhvillimit dhe Bashkëpunimit, Njësia e Politikave për Zhvillim dhe Mirëqeverisje, Njësia e Projekteve Kombëtare të Zhvillimit*), etj.

Për periudhën objekt auditimi, është hartuar Strategjia për Menaxhimin e Risqeve në institucionin e Kryeministrit, por ky dokument nuk është miratuar ende.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 58 - 70 të Raportit të Auditimit)*

### **11. Rekomandimi:**

**11.1.**Strukturat menaxheriale të Kryeministrit të marrin masa që të plotësohet regjistri i riskut me të gjithë njësitë/ departamentet/ drejtoritë dhe sektorët; të rishikohet çdo vit regjistri i riskut dhe të bëhet përditësimi dhe miratimi i tij, për të mundësuar vendimmarrje cilësore, optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura, konformë përcaktimeve të kreut III, pika 3.2 "Menaxhimi i riskut", të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

*Në vijimësi*

**11.2.**Nëpunësi Autorizues në bashkëpunim me Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe në koordinim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të azhurnojë dhe të miratojë dokumentin e strategjisë afatmesme të menaxhimit të risqeve, së bashku me planin e veprimit për arritjen e objektivave të programit, e cila duhet të përditësohet rregullisht (*çdo tre vjet*), ose sa herë që në mjedisin e institucionit ndodhin ndryshime të rëndësishme strukturore.

#### **D. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE:**

Nisur nga problemet e konstatuara në këtë auditim për të cilat janë lënë rekomandimet përkatëse, KLSH do të ndjek me vëmendje të veçantë dhe do vlerësojë marrjen e masave, që do të marrë Kryeministria për zbatimin e rekomandimeve të dërguara, reflektimin e tyre me qëllim përmirësimin e punës në të ardhmen.

Në përfundim të afateve të përcaktuara në rekomandimet e lëna në këtë auditim dhe afatin e caktuar, në nenin 15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për masat e marra dhe për zbatimin e rekomandimeve të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit.

*Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore.*

---

**Arben SHEHU**

**KRYETAR**